



I vaksinuar – i mbrojtur: në qendrën ditore për fëmijë dhe qendrën ditore të përkujdesjes për fëmijë



Të dashur prindër!

Fëmija juaj shkon për herë të parë në qendrën ditore për fëmijë ose në një qendër ditore të përkujdesjes për fëmijë ("Kita" – kopshte ditore).

Jepni fëmijës suaj sigurinë e nevojshme, duke lejuar që ai të mbrohet më së mirë kundër shumë sëmundjeve infektive.

I vaksinuar – i mbrojtur: Siguri për fëmijën tuaj dhe për të tjerët

Pikërisht fëmijët në moshë foshnjore dhe të mitur janë të rrezikuar ndaj shumë sëmundjeve infektive tepër ngjitëse. **Prandaj, para hyrjes në kopsht duhet të kontrolloni vaksinimin e fëmijës suaj dhe, nëse mungon ndonjë vaksinim, duhet ta vaksinoni fëmijën!**

Duke bërë vaksinimin mbron fëmijën tuaj. Përveç kësaj, ju merrni përsipër edhe një përgjegjësi sociale: Si rregull, fëmijët e vaksinuar nuk ua ngjisin sëmundjen të tjerëve dhe, në këtë mënyrë, u jepni siguri të gjithë atyre, të cilët, p.sh., janë ende shumë të vegjël për t'u vaksinuar, ose që nuk mund të vaksinohen për shkak të imunitetit të dobët. Në këtë mënyrë mbrohen edhe nëna shtatzëna të pavaksinuara dhe fëmijët e tyre që nuk kanë lindur ende.

Vaksina kundër fruthit– pse është aq e rëndësishme?

Fruthi nuk është i padëmshëm. Fruthi dobëson sistemin e imunitetit për disa muaj. Kjo mund të përgatisë rrugën për shumë infeksione të tjera, të tilla si infeksionet e mushkërive ose infeksionet e veshit të mesit. Një rrezikshmëri të lartë paraqet infeksioni cerebral, i cili shfaqet te një nga 1000 fëmijë të sëmurë dhe mund të lërë pasoja afatgjata.

Fruthi është tepër ngjitës. Virusi i fruthit mund të transmetohet lehtë nga një person te tjetri, p.sh. gjatë të folurit. Sëmundja mund të ngjitet edhe 3 – 5 ditë para shpërthimit tipik të lëkurës.

Ndalimi i vizitave kur shpërthen sëmundja. Nëse ka një rast fruthi në kopsht, fëmijët e pavaksinuar, zakonisht, mund të përjashtohen nga ndjekja e kopshtit.

Vaksinim i munguar? Nuk ka problem.

Vaksinimet e munguara mund të rikuperohen në çdo kohë. Shfrytëzoni mundësinë dhe rifreskoni mbrojtjen me vaksinë të fëmijës suaj, por edhe të të gjithë familjes.

Efekti dhe siguria i të gjitha vaksinave të rekomanduara kontrollohet vazhdimisht me rreptësi nga institucionet shtetërore. Avantazhet e këtyre vaksinave tejkalojnë ndjeshëm rreziqet e vogla.

Lidhur me pyetjet rreth temës së vaksinimit, mjeket dhe mjekët në të gjithë Bavarinë dhe Zyra juaj e Shëndetit janë të hapur që t'ju këshillojnë. Informacione aktuale dhe të detajuara lidhur me vaksinimin i gjeni edhe në internet në faqen www.impfen.bayern.de.

